

Ekran helmetë

Udhëzuesi i fillimit



Përpara përdorimit, referojuni gjithashtu "Masat paraprake shëndetësore" dhe "Masat paraprake" në "Udhëzuesi i referencave".


HMZ-T2

Zgjidhja e mungesës së audios, videos ose riprodhimit në 3D nga një PlayStation®3 (PS3™)

Problemet me audion dhe videon mund të ndodhin kur ndryshohet dalja e PS3™ me një nga metodat e mëposhtme.

- Ndryshohet dalja në këtë sistem duke përdorur funksionin e pasazhit HDMI të sistemit.
- Ndryshohet dalja në këtë sistem duke lidhur PS3™ dhe këtë sistem direkt, pasi përdorni PS3™ me televizorin.

Në këtë rast, ndërkohë që sistemi është i ndezur, fikni PS3™ dhe më pas mbajeni të shtypur butonin e energjisë të PS3™ për të paktën 5 sekonda (derisa të dëgjoni një tingull tjetër bip) për ta rindezur atë.



"PlayStation" është markë tregtare e regjistruar e Sony Computer Entertainment Inc. Gjithashtu, edhe "PS3" është markë tregtare e të njëjtës kompani.

Çfarë ka në kuti



Njësia helmetë



Njësia e përpunimit



Kufjet



Kablloja HDMI

Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)
Aksesorët
Dokumentacioni




Printuar me bojë vaji me bazë vegjetale pa VOC (përbërës organikë të ajrit).

© 2012 Sony Corporation
4-439-021-11(1) (AL)

1 Lidhja

1 Lidhni pajisjen e riprodhimit dhe një televizor.




Nëse pajisja juaj e riprodhimit ka vetëm një fole HDMI OUT, mund të shikoni gjithsesi video nga pajisja e riprodhimit në televizor duke e lidhur televizorin me njësinë e përpunimit me një kabllo HDMI të shpejtësisë së lartë. Në këtë rast, vendoseni "HDMI pass-through" te "General Setup" në "On".


Shënim

- Pasazhi HDMI nuk aktivizon riprodhimin njëherësh të videos në njësinë helmetë dhe në televizor.


2 Lidhja e njësisë helmetë.



3 Lidhni kufjet e dhëna.




4 Lidhni kordonin elektrik (dalja e korrentit) dhe futeni në prizë.



5 Ndizni sistemin (⏻).

Treguesi i energjisë në njësinë e përpunimit tani ndizet në të gjelbër.




6 Ndizni pajisjen e riprodhimit (⏻).

Vazhdon në **2** Vendosja →


2 Vendosja

Vendosja e njësive nuk do t'ju lejojë të shihni jashtë ekranit. Përpara se ta vendosni, merrni pak kohë për të rishikuar hapat 2 - 4 (Vendosja, Konfigurimi dhe Shijojeni), në mënyrë që të njihni sekuencën e procedurës.



Për një vendosje komode


- A** Njësia duhet të mbështetet mes ballit dhe dy pozicioneve në pjesën e pasme të kokës.
- B** Mos e vendosni peshën mbi hundë.
- C** Rregullojeni njësine në mënyrë që ekranet t'i keni përpara syve.



Nëse mbani normalisht syze ose lente kontakti, mbajni ato si zakonisht (me përjashtim të syzeve të leximit). Vini re se shikimi me syze bifokale mund të mos jetë optimal.



- 1 Tërhiqni shiritin e kokës.**
Nga njëra anë në tjetrën, mbajeni të shtypur butonin e lirimit të shiritit dhe tërhiqni shiritin e kokës.
- 2 Vendosni në kokë njësine helmetë.**
Uleni shiritin e poshtëm të kokës në bazën e kokës.



- 3 Rregulloni pozicionin në kokë.**
Rregulloni me kujdes njësine majtas, djathtas, lart dhe poshtë për të gjetur pozicionin më të mirë për të parë qendrën e ekraneve.
- 4 Shtërngoni shiritin e kokës mirë.**

3 Rregulloni pozicionin në kokë.

Rregulloni me kujdes njësine majtas, djathtas, lart dhe poshtë për të gjetur pozicionin më të mirë për të parë qendrën e ekraneve.

Shënime

- Nëse njësia dikton se mbështetësja e ballit **D** nuk është vendosur në ballë gjatë shikimit, ekranet do të çaktivizohen. Sigurohuni që mbështetësja e ballit të qëndrojë mirë në ballë.
- Nëse mbështetësja e ballit **D** është shumë prapa (drejt ballit tuaj), mund jetë e vështirë të shohësh ekranet. Në këtë rast, duke mbajtur levën bllokuese **E** në të majtë, ngrini mbështetësen e ballit dhe shtyjeni mbështetësen përpara.


4 Shtërngoni shiritin e kokës mirë.

Këshillë

- Gjatësia e shiritave të sipërm dhe të poshtëm të kokës mund të rregullohet. Për detajet e cilësimit, shihni "Udhëzuesi i referencave".

5 Vendosni kufjet.

Vendosni aurikularin e shënuar R në veshin e djathtë dhe atë të shënuar L në veshin e majtë.




Për të hequr njësine helmetë


- Hiqni kufjet nga veshët përpara se të hiqni nga koka njësine helmetë.
- Mbani shtypur butonat e lirimit në të dyja anët dhe tërhiqni njësine përpara ndërsa e ngrini për ta hequr.

3 Konfigurimi

Ndiqni udhëzimet e shfaqura në ekran për përdorimin.




- 1 Zgjidhni një gjuhë për ekranin (vetëm herën e parë).**
Shtypni butonin ▲/▼ për të përzgjedhur një gjuhë, dhe më pas shtypni butonin MENU ose butonin ►.
- 2 Rregulloni hapësirën mes lenteve.**
Rrëshqitni rregulluesin e hapësirës së secilës lente derisa t'i shikoni qartë të dy ekranet. Pas rregullimit, shtypni butonin MENU ose butonin ►.



Këshilla

- Nëse nuk arrini të shihni ekranin qartë pas rregullimit të hapësirës mes lenteve, filloni nga fillimi nga pjesa "2 Vendosja".
- Nëse rregullimi është i vështirë, provoni të rrëshqisni të dy rregulluesit në pozicionin qendror përpara rregullimit.



3 Kontrolloni drejtvendosjen e pamjes.
Konfirmoni që të tre shenjat "I" dhe vija horizontale të ndërpriten, dhe më pas shtypni butonin MENU ose ►. Është e pranueshme nëse shenjat dhe vija horizontale kryqëzohen në një pozicion tjetër nga qendra e ekranit.

Shënim


- Edhe nëse vetëm një nga shenjat "I" dhe vija horizontale nuk ndërpriten, mos e përdorni sistemin. Për detajet e cilësimit, shihni "Udhëzuesi i referencave".

Më shumë se një nga shenjat "I" dhe vija horizontale nuk ndërpriten.

4 Shijojeni

Kontrolloni riprodhimin nga burimet e përputhshme të riprodhimit.

Kontrolli i riprodhimit nga njësia



- Përshejto prapa**
Mbani shtypur butonin për të kaluar në kapitullin e mëparshëm.
- Luaj**
- Ndezur/në gatishmëri**
Mbani shtypur butonin për të kaluar në modalitetin e gatishmërisë.
- Përshejto përpara**
Mbani shtypur butonin për të kaluar në kapitullin tjetër.
- Pauza**
- Volumi**
- VOL +

Shënime

- Sistemi nuk mund të përdoret për kontroll të përparuar të pajisjes së riprodhimit, siç është përdorimi i menysë.
- Kontrolli përmes këtyre butonave është i mundshëm vetëm kur "Control for HDMI" në "General Setup" vendoset në "On" (cilësimi i parazgjedhur).
- Disa pajisje riprodhimi nuk mund të kontrollohen duke përdorur butonat në njësine helmetë.

Për detaje mbi konfigurimin e cilësimeve të menysë dhe aksesorëve të bashkëngjitur, shikoni "Udhëzuesi i referencave".

Shënim

- Për të zgjidhur mungesën e audios, videos ose riprodhimit të 3D kur sistemi është i lidhur me një PlayStation®3 (PS3™), shikoni udhëzimet në faqen në të djathtë të kapakut për zgjidhjen e problemeve.